



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:159066

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06375754

APS.nr.35/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani kryetar i kolegjit, Burim Ademi dhe Mentor Bajraktari anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Gazmend Ramadani, në çështjen penale ndaj të akuzuarve A.B nga Prishtina, V.M nga fshati Kryshec, Komuna e Obiliqit, A.A nga fshati Nakaradë, Komuna Obiliq, dhe A.T nga Prishtina, për shkak të veprës penale Shpëlarja e parave nga neni 302 i KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 nën par.1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PS.nr.33/2021 i datës 24.04.2023, në seancën e kolegjit me datë 20.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Special, PS.nr.33/2021 i datës 24.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, ka marrë aktgjykimin PS.nr.33/2021 të datës 24.04.2023, me të cilin nën dispozitivin I, II, III dhe IV, i ka liruar nga akuza, të akuzuarit A.B, V.M, A.A dhe A.T, për shkak të veprës penale Shpëlarja e parave nga neni 302 i KPRK-

së, lidhur me nenin 56 par.1 nën par.1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit, për shkak se nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë:

- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa, aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet për rigjykim dhe vendim.
- Përgjigje në ankesë e prokurorisë ka parashtruar mbrojtësi i të pandehurit A.A av. Behar Ejupi, me propozim që të refuzohet ankesa e prokurorisë dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.
- Përgjigje në ankesë e prokurorisë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit V.M av. Teuta Zhinipotoku me propozim që të refuzohet ankesa e prokurorisë dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtresën me shkrim PPA/I.nr.446/23 të datës 16.08.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale, kurse aktgjykimi të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit fillimisht ka vlerësuar ankesën nëse është e lejueshme dhe e afatëshme. Kolegji ka gjetur se ankesa është e lejueshme, duke qenë se është parashtruar nga ana e prokurorisë. Po ashtu ankesa rezulton se është e afatëshme, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se aktgjykimi e ankimuar prokuroria e ka pranuar me datë 13.07.2023, kurse ankesa është parashtruar me datë 19.07.2023, kurse përgjigje në ankesë kanë parashtruar mbrojtësi i të pandehurit A.A av. Behar Ejupi me date 27.07.2023 dhe mbrojtësja e të pandehurit V.M av Teuta Zhinipotoku me date 28.07.2023. Nga këto rrethana rezulton se ankesa është brenda afatit që parasheh neni 380 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën ka njoftuar palët për vendin, kohën e mbajtjes së seancës. Në këtë seancë nuk kanë prezantuar: Prokurori i Prokurorisë së Apelit, i akuzuarit A. B, i akuzuari V.M, edhe pse ftesat i'u janë dorëzuar në mënyrë të rregullt. Ndërsa, janë të pranishëm: mbrojtësi i të pandehurit A.B me autorizim zëvendësues av. Driton Musliu, mbrojtësi i të pandehurit V.M me autorizim zëvendësues av. Ilir Bekteshi, i akuzuari A.A dhe mbrojtësi i tij av. Behar Ejupi, i akuzuari A.T dhe mbrojtësja e tij av. Sahadete Gashi.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të prokurorisë, mbrojtësve të akuzuarve, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore.

Në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, thekson se sa i përket lirimit nga akuza ndaj të akuzuarve, gjykata gabimisht ka ardh në përfundim se nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale, ngase bazuar në veprimet e ndërmarra nga të akuzuarit, janë përmbushur në tërësi elementet qenësore të veprës penale. Elementi i parë (vendosja – faza e parë) është përmbushur përmes transferimit të parave të fituar me aktivitet kriminal, pa ndonjë përshkrim nga persona të ndryshëm nga Turqia dhe Republika Domenikane në emër të akuzuarve, në institucionet financiare “Eëstern union” dhe “Money Gram”, që t'i integrojnë në sistemin financiar në Kosovë që në shikim të parë të duken si të ligjshme, pasi që dihet mirë se sikur të ishin transferuar përmes bankave tjera komerciale, do të kërkohej edhe përshkrimi tekstual i qëllimit të dërgesës së parave, kurse sipas rregullave bankare në EëU dhe MG, nuk kërkohej. Elementi i dytë (shtresimi – faza e dytë, ka ndodhur pasi të akuzuarit kanë pranuar paratë në emër të tyre, më pas kanë filluar t'i tërheqin në shuma të ndryshme, mirëpo nën pragun prej 10.000 euro, si dhe kanë autorizuar persona të ndryshëm për tërheqje të shumave të ndryshme të mjeteve monetare, duke i paguar/shpërblyer për çdo tërheqje të bërë. Elementi i tretë (integrimi – faza finale) ka ndodhur, pasi të akuzuarit kanë tërhequr paratë vet apo përmes personave të ndryshëm, në mënyrë që më pas t'i përdorin për qëllime të ndryshme, duke përfituar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete.

Sipas ankesës, gjykata nuk ka marrë për bazë faktin, se të akuzuarit kanë autorizuar persona të ndryshëm për tërheqjen e shumave të ndryshme të mjeteve monetare në emër të tyre, pranë institucioneve financiare, që do të thotë nëse të akuzuarit nuk paskan qenë në dijeni se paratë janë të dyshimta apo burojnë nga ndonjë aktivitet kriminal, pse kanë autorizuar persona të ndryshëm për tërheqjen e tyre dhe nuk i kanë tërhequr vet ata personalisht. Më tutje, thekson se të akuzuarit kanë gënjyer dëshmitarët duke fshehur origjinën e parave, ashtu që ju kanë thënë se janë nga gruaja apo familjarët e tjerë, kurse e kanë ditur fare mirë se nga kush vijnë, gjë që shpërfaq dijeninë e tyre për origjinën e parave – aktivitetit kriminal. Edhe ekspertiza financiare e hartuar nga eksperti financiar Ramadan Ferizi e datës 20.01.2023, vërteton se të akuzuarit kanë realizuar tërheqje parash në shuma të precizuara si në ekspertizë, po ashtu shumat e sakta të tërhequra nga secili person me emër dhe mbiemër i përfshirë në aktakuzë. Të gjitha transaksionet nuk kanë ndonjë përshkrim tekstual të qëllimit të dërgimit të parave, por vetëm emrat e plotë të dërguesve e pranuesve të parave, të identifikuar me letërnjoftim si dhe emërtimin e shteteve prej nga vijnë dhe ku tërhiqen paratë, përfshirë edhe datën e tërheqjes. Gjithashtu, edhe plotësim ekspertiza – rekapitulacioni mbi shumat e tërhequra të mjeteve nga personat – dëshmitarët për periudhën 01-31.12.2013 – 01-31.12.2024 nga Republika e Turqisë dhe Dominikane, vërteton se të pandehurit apo dëshmitarët kanë pranuar paratë në EU dhe MG në emër të vetin dhe secili ka nënshkruar paratë që i ka tërhequr, që nuk kontestohet nga të pandehurit, e këta të fundit nuk kanë dhënë autorizim në formë të shkruar, por vetëm kanë kërkuar nga dëshmitarët që të tërheqin para në emër të tyre, duke i shpërblyer për tërheqjet e bëra. Pra, gjykata gabimisht vërteton gjendjen faktike dhe bën shkelje të ligjit penal, sepse në veprimet e të akuzuarve manifestohen elementet e veprës penale, e cila iu vihet në barrë dhe kjo vërtetohet nga provat materiale, por edhe provat personale.

Përgjigje ne ankesë e prokurorisë ka parashtruar mbrojtësi i të pandehurit A.A av.Behar Ejupi, duke konsideruar se ankesa e prokurorisë është e pabazuar ngase gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur të pandehurin e ka liruar nga akuza për shkak se nuk është vërtetuar se i ka kryer veprën me të cilën ngarkohet. Sa i përket pretendimeve lidhur me elementet e veprës penale konsideron se të njëjtat nuk qëndrojnë pasi që me asnjë provë nuk është konstatuar se paratë e pranuar kanë rrjedhë nga aktiviteti kriminal, e kjo është vërtetuar edhe me përgjigjet e marra nga autoritetet Dominikane dhe Turke. Ndërsa sa i përket pretendimeve për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike konsideron se gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendje faktike, andaj propozon që të refuzohet si e pabazuar ankesa e prokurorisë dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit V.M av. Teuta Zhinipotoku duke e konsideruar se gjykata ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike e ku edhe ka marrë aktgjykim lirues. Gjetjet e gjykatës se për kryerjen e veprës penale të shpëlarjes së parave, fillimisht është e nevojshme të vërtetohet se pasuria a buron nga ndonjë aktivitet kriminal, pra duhet medoemos që pasuria të jetë rrjedhojë e përfitimeve të ardhura nga aktiviteti kriminal, dhe ai synon ta pastrojë atë pasuri, duke i dhënë trajtën e një pasurie apo avantazhi ekonomik të ligjshëm. Pra, autori me qëllim të pastrimit të kësaj pasurie duhet të kryejë veprimin i cili përfshihet në njërin nga format e parashikuara në nenin 56 për shpëlarje të parasë. Aktakuza është e ngritur duke u nisur nga rrethana gjeneralë se kinse i mbrojturi i saj ka kryer veprime inkriminuese derisa të gjitha veprimet të cilat i veshën kanë qenë të ndërmarra nga pavetëdija dhe se nuk e ka ditur se të njëjtat veprime janë të ndaluara. I pandehuri i ka kryer veprimet e njëjta sikurse edhe dëshmitarët e tjerë të cilët janë pjesë e kësaj procedure, mirëpo ky është i vetmi ndaj të cilit prokuroria ka ngritur aktakuzë pa e vërtetuar me asnjë provë bindëse dhe konkrete, dhe me asnjë nga veprimet e tija nuk janë përmbushur elementet e veprës penale. Andaj, propozon që të refuzohet si e pabazuar ankesa e prokurorisë dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Përkundër se Prokuroria speciale nuk ka parashtruar ankese për bazën ligjore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo gjykatë aktgjykimin e ka analizuar nëse i njëjti është i përfshirë me shkelje esenciale, duke qenë se dispozita ligjore nga neni 394 paragrafi 1 përcakton se Gjykata e Apelit ka për detyrim që të shqyrtoj ankesën sipas detyrës zyrtare nëse aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Kolegji vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të parapara nga neni 384 paragrafi 1 i Kodit të procedurës penale, për çka do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Kolegji vlerëson se aktgjykimi është i përpiluar në përputhje me dispozitat ligjore, dhe se në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit janë të përshkruara rrethanat e fakteve si për sa i përket kohës, vendit dhe mënyrës që pretendohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale, po ashtu

dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe konkret dhe se nuk ka kundërthënie ne vetvete dhe as në raport me arsyet.

Po ashtu aktgjykimi i ankimuar ka arsyetim lidhur me te gjitha rrethanat faktike, lidhur me provat qe janë administruar si dhe ka arsyetuar edhe rrethanat se si gjykata ka bere zgjidhjet ligjore ne këtë çështje penale, tutje kolegji vëren se gjykata ka bere arsyetimin ne raport me çdo prove dhe ne tërësinë e tyre për çka kolegji i gjykatës se apelit vlerëson se aktgjykimi ka arsyetimin për faktet vendimtare dhe se konkludimet e nxjerra nga gjykata e shkallës së parë janë të pranueshme dhe të drejta edhe për këtë gjykate.

Andaj për këto rrethana kolegji ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale qe do te kushtëzonin anulimin e aktgjykimit.

Lidhur me pretendimet ankimore për sa i përket vërtetimit te gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji duke vlerësuar pretendimet e prokurorisë, dhe arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës se parë, ne raport me faktet që janë vërtetuar dhe ato qe nuk janë vërtetuar, gjen se pretendimet e prokurorisë për vërtetim te gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, janë të pabazuara.

Kolegji ka parasysh se, te pandehurit ngarkoheshin secili veç e veç për veprën penale të shpëlarjes se parave nga neni 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 te ligjit për parandalimin e shpëlarjes se parave dhe financimin e terrorizmit e lidhur me nenin 302 te Kodit Penal.

Lidhur me rrethanat faktike kolegji po ashtu ka parasysh se, të pandehurit përkundër se ngarkohen veç e veç për vepër penale, në thelb rrethanat e fakteve ngarkohen për: “ Se në periudhën kohore nga vitit 2013 deri ne vitin 2014, duke qenë ne dijeni se paratë burojnë nga aktiviteti kriminal dhe me qellim të përfitimit të dobisë pasurore që mënyrë të kundërligjshme kanë pranuar shuma të mëdha të mjeteve financiare nga personat e panjohur nga Republika e Turqisë dhe Republika Domenikane me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë se pasurisë se tij ne atë mënyrë qe fillimisht i kanë tërhequr mjetet monetare e me pas për ti realizuar qëllimet e tyre përmes institucioneve financiare Ëestern Union dhe Money Gram ne Kosovë ne shumat e përshkruara ne dispozitiv”.

Nga aktgjykimi dhe procesverbalet rezultojnë se gjykata e shkalles se pare, ka administruar provat ne këtë çështje penale dhe atë, ka dëgjuar dëshmitarët, F.K, B.G, A.Sh e A.Z, F.SH, N. B

e S.L kanë tërhequr te holla A. B, ndërsa dëshmitaret Xh.G dhe Y.J kanë tërhequr mjete monetare për V.M, ndërsa dëshmitarët B.P F.B, M.B, S.S, Sh.A e A.Th kanë tërhequr mjete monetare për A.A, ndërsa dëshmitaret E.Z ka tërhequr mjete monetare për personin e quajtur “Turku” te cilin e ka përshkruar se si dukej ky person.

Poashtu nga aktgjykimi rezulton se janë administruar provat materiale, si komunikimi i ILCEU – 1282-17-23 i datës 23.07.2018 lëshuar nga Policia e Kosovës, Raporti Informues i Administratës Tatimore të Kosovës me nr 149/2021 i datës 21.04.2021, Raporti informues mbi zbulimin e te dhënave financiare me nr 2020 – KE -82 i datës 29.01.2020 lëshuar nga policia e Kosovës, Raporti informues mbi zbatimin e autorizimeve – deklarata e të pandehurve, Ekspertiza Financiare e datës 20.01.2023, dhe shtesa- raporti Rikapitulacion i datës 28.03.2023.

Poashtu nga aktgjykimi rezulton se është dëgjuar në shqyrtim gjyqësor i pandehuri A.T, ndërsa te pandehurit A.B, V. M dhe A.A kanë shfrytëzuar te drejtën e tyre për tu mbrojtur ne heshtje ndërsa janë lexuar deklaratimet e tyre të dhëna ne polici.

Kolegji nga parasysh se siç ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë, nga provat që janë administruar rezulton, se dëshmitaret pa përjashtim kanë pohuar se kanë tërhequr mjete monetare sipas kërkesave nga te pandehurit që ata iu kanë kërkuar duke qene se disa nga dëshmitarët janë fqinje të të pandehurve disa janë miq me te pandehurit e disa kanë njohje apo raporte familjare me te pandehurit, çka provohet fakti se mjetet monetare janë tërhequr nga dëshmitarët sipas kërkesave të të pandehurve që ata kishin kërkuar që këta dëshmitar ti tërheqin këto to holla në këtë periudhë kohore ne këto dy institucione financiare e që janë dërguar nga Turqia, Republika Domenikane dhe nga Bullgaria.

Njëkohësisht as të pandehurit nuk kanë mohuar se ata iu kanë kërkuar këtyre dëshmitarëve që të tërheqin këto të holla, përveç se të pandehurit theksojnë se këto tërheqje janë bërë për shkak të kërkesës së personit Turk me te cilin ishin njohur ne rrethanë te ndryshme dhe se mjetet monetare i ishin dhënë atij ndërsa vet te pandehurit apo dëshmitarët kishin pranuar shpërblim në shumat prej 20-30 euro, ndërsa këto po ashtu theksojnë se nuk kanë qenë në dijeni se një veprim i tillë është i paligjshëm por se kanë menduar se vetëm vlerat mbi 10.000 euro është diçka e paligjshme.

Kolegji i pranon si te drejta vlerësimet dhe arsyetimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë lidhur me këto prova dhe konkludimet e nxjerra kur ka konstatuar se në vetvete pohimet e të

pandehurve se kanë bërë tërheqjen e mjeteve monetare dhe pohimet e dëshmitarëve provojnë rrethanën e tërheqjes se mjeteve monetare në këto dy institucione.

Kolegji ka parasysh se, thelbësore në këtë çështje penale ishte se të pandehurit, a e kanë ditur apo a kishin mundësi për ta ditur se pasuria – mjetet monetare janë rrjedhojë nga aktiviteti kriminal.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar rrethanat e fakteve nën të cilat ngarkoheshin të pandehurit, rezulton se, prokuroria nuk ka arritur që të vërtetoj fillimisht se pasuria ishte burim i aktivitetit kriminal për të kaluar pastaj të elementi subjektiv i dijeni apo mundësisë që të pandehurit e kanë ditur se kjo pasuri ishte rrjedhojë e aktivitetit kriminal.

Kolegji ka parasysh se të pandehurit ngarkoheshin për veprimet e tilla të tërheqjes se mjeteve monetare që ishin dërguar nga Republika e Turqisë dhe Republika Domenikane, rrjedhimisht nga shkresat e lëndës rezultojnë dy prova të dërguara nga Policia përmes bashkëpunimit policor që i ishin drejtuar autoriteteve policore të këtyre shteteve për të sqaruar se personat që kishin dërguar mjetet monetare a kanë ndonjë aktivitet kriminal, gjë që sipas raportit të ILECU me nr. 1282-17-23 i datës 23.07.2018 autoritetit të Republikës Domenikane kanë kthyer përgjigje duke sqaruar se personat që kanë dërguar mjete monetare për të cilët është kërkuar verifikimi nuk kanë të kaluar kriminal e as po qesë në zhvillim e sipër të autoritetet respektive të këtij vendi.

Kjo provë qartësisht rrezon pretendimin e prokurorisë për të arsyetuar se mjetet monetare rrjedhin nga një aktivitet kriminal duke qenë se verifikimet e bëra pranë autoriteteve në Republikën Domenikane nuk kanë ndonjë aktivitet kriminal, ndërsa nuk ka asnjë provë tjetër për të argumentuar se këta persona që ishin verifikuar të kenë aktivitete tjetër kriminal.

Ndërsa Autoritetet e Republikës së Turqisë nuk i ishin përgjigjur kërkesës së tillë të Policisë së Kosovës përmes ILECUT, rrjedhimisht gjykata nuk mund të mbështesë vërtetimin e këtij fakti thelbësor se mjetet e dërguara nga Republika e Turqisë ishin pasuri që rrjedhë nga aktiviteti kriminal, duke qenë se është vetëm fakt i supozua i pambështetur me ndonjë provë konkrete. Kolegji për këtë rrethanë vlerëson se prokuroria këtë fakt e ka mbështetur duke u bazuar në rrethana se mjetet monetare ishin dërguar nga Turqia dhe përderisa ishin dërguar ku shumë persona kishin bërë tërheqjen e këtyre mjeteve monetare me kërkesën e të pandehurit ato përbejnë pasuri që rrjedhë nga aktiviteti kriminal, kjo për kolegjin e Gjykatës së Apelit ka përbërë

vërtet një baze për dyshim të arsyeshëm, mirëpo fakti se mjetet monetare ishin dërguar në Ëestern Union dhe në Money Gram kur të pandehurit i kishin tërhequr qoftë edhe duke iu kërkuar personave të tjerë kjo nuk provon përtej dyshimit se kjo pasuri ishte rrjedhojë e aktivitet kriminal.

Prandaj gjykata e Apelit duke gjetur se mjetet monetare që të pandehurit i kishin tërhequr qoftë edhe duke iu kërkuar personave të njohur të tyre që ata ti tërhiqnin, e duke mos u provuar se këto mjetet monetare rrjedhin nga aktiviteti kriminal, rrjedhimisht as elementi subjektiv i dijenisë apo mundësisë së dijenisë nga të pandehurit nuk mund të provohet, pasi që për tu provuar elementi subjektiv i dijeni se të pandehurve apo mundësisë që ata kishin për ta ditur se këto mjete monetare ishin pasuri që rridhte nga aktiviteti kriminal, fillimisht duhet të provohet përtej çdo mëdyshje se ajo pasuri ishte rrjedhojë e aktivitet kriminal gjë që siç u sqarua nga Republika Domenikane ka konfirmim se personat që kanë dërguar nuk kanë ndonjë aktivitet kriminal ndërsa Republika e Turqisë nuk ka konfirmuar asnjë rrethanë pasi që nuk ka kthyer përgjigje, rrjedhimisht rezulton i paprovuar fakti me thelbësore që kjo pasuri ishte e krijuar nga aktiviteti kriminal, andaj në këtë këndvështrim është logjik edhe konkludimi se të pandehurit nuk kanë pasur mundësi dhe as nuk e kanë ditur se kjo pasuri ishte nga aktiviteti kriminal përderisa nuk është provuar se vërtet është pasuri nga aktiviteti kriminal.

Andaj për këto shkaqe kolegji i gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të prokurorisë për vërtetim të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike janë të pabazuara, duke gjetur se aktgjykimi i ankimuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike.

Lidhur me pretendimet e prokurorisë për shkelje të ligjit penal, kolegji këto pretendime i gjen të pabazuara, duke qene se prokuroria këtë baze ligjore të ankimit e pretendon se shkelja e ligjit penal ka ardhur si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, ky kolegji duke gjetur se drejtë dhe në mënyrë të plote është vërtetuar gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë, rrjedhimisht nuk kemi të bëjmë me shkeljen e ligjit penal.

Andaj, për arsyet e theksuara si më lartë kjo Gjykatë bazuar në nenin 401 të KPRK-ës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti Special

APS.nr.35/3023 me datë 20.09.2024

B. Profesional
Gazmend Ramadani

Anëtarët e kolegjit
Burim Ademi

Kryetar i kolegjit,
Ferit Osmani

Mentor Bajraktari
